



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

Në mbështetje të nenit 17 paragrafi 1, shkronjat f dhe n të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, të Ligjit nr. 05/L-088 për Rregullat e Trafikut Rrugor, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-069, si dhe të nenit 33 paragrafi 33.1 shkronja a të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110-391, datë 25.02.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më datë __/__/2026, miraton këtë:

RREGULLORE (K.Pr) NR. ____/2026
PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E
RREGULLORES 01. Nr. 110-1205 (K.PR) PËR SHËRBIMIN E TRANSPORTIT ME
“MERIMANGË” PËR TERRITORIN E KOMUNËS SË PRISHTINËS

Neni 2

2.2. Pas konstatimit të shkeljes së rregullave të ndalimit ose parkimit nga zyrtari policor ose nga personi i autorizuar nga organi kompetent komunal, automjeti që është ndaluar ose parkuar në kundërshtim me rregullat e trafikut rrugor, mund të zhvendoset ose të bllokohet, në pajtim me këtë Rregullore dhe legjislacionin në fuqi.

2.3. Para nxjerrjes së urdhrit për zhvendosjen ose bllokimin e automjetit, pozita e automjetit të ndaluar ose të parkuar në mënyrë të parregullt dëshmohet me fotografi ose me skicë.

Neni 3 Zhvendosja dhe bllokimi

3.2. Automjetet e ndaluara ose të parkuara në mënyrë të parregullt zhvendosen ose bllokohen me urdhër të zyrtarit policor ose të personit të autorizuar nga organi kompetent komunal, në pajtim me kompetencat e përcaktuara me legjislacionin në fuqi.

Autobusët, automjetet transportuese, automjetet e punës, mjetet bashkëngjitëse, rimorkiot dhe gjysmë-rimorkiot, kur ndalohen ose parkohen në kundërshtim me rregullat ose në vende që nuk janë të destinuara për parkimin e tyre, mund të bllokohen ose të zhvendosen në të njëjtën mënyrë.

3.5. Operatorët për ofrimin e shërbimit të transportit me “merimangë” përzgjidhen nëpërmjet procedurave të hapura publike, në përputhje me legjislacionin në fuqi, mbi bazën e kriterëve teknike, profesionale dhe financiare të përcaktuara nga Komuna e Prishtinës.

3.6. Operatori i licencuar për zhvendosjen e automjeteve duhet të disponojë pajisjet, mjetet teknike dhe kapacitetet e nevojshme për zhvendosjen, tërheqjen dhe transportimin e automjeteve, kur këto masa urdhërohen nga organet kompetente.

3.7. Komuna e Prishtinës, sipas nevojës dhe në pajtim me legjislacionin në fuqi, mund të licencojë edhe operatorë të veçantë për bllokimin dhe zhblokimin e automjeteve.

3.8. Operatori i licencuar për bllokimin dhe zhblokimin e automjeteve duhet të disponojë pajisjet, mjetet teknike dhe kapacitetet e nevojshme për bllokimin dhe zhblokimin e automjeteve, kur këto masa urdhërohen nga organet kompetente.

Neni 4

4.1. Komuna e Prishtinës licencon operatorët e përzgjedhur për ofrimin e shërbimit të transportit me “merimangë”, në pajtim me kushtet dhe kriteret e përcaktuara me këtë rregullore dhe legjislacionin në fuqi.

4.2. Licensa nga paragrafi 4.1 i këtij neni lëshohet për kohë të caktuar, deri në tre (3) vjet, me mundësi vazhdimi, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

Neni 5

5.2. Operatori nuk lejon lirim të automjetit të zhvendosur ose të bllokuar pa u bërë identifikimi i pronarit ose i drejtuesit të automjetit dhe pa u kryer pagesa e tarifës së përcaktuar me këtë rregullore.

5.3. Në rastet kur për automjetin është shqiptuar edhe gjobë ose masë tjetër nga organi kompetent, veprohet sipas aktit të atij organi dhe legjislacionit në fuqi.

Neni 10

Tarifa e shpenzimeve

10.1. Tarifa e shpenzimeve për zhvendosjen, bllokimin, zhblokimin dhe ruajtjen e automjeteve në vendin e caktuar, përcaktohet si më poshtë:

1. Për zhvendosjen e motoçikletës, traktorit dhe veturës pa rimorkio, brenda zonës urbane, deri në vendin e caktuar për vendosje dhe ruajtje deri në 24 orë, tarifa është pesëdhjetë (50) euro.
2. Për zhvendosjen e automjetit transportues, autobusit, rimorkios ose gjysmë-rimorkios, brenda zonës urbane, deri në vendin e caktuar për vendosje dhe ruajtje deri në 24 orë, tarifa është njëqind (100) euro.

10.2. Për zhvendosjen e automjeteve nga paragrafi 1 i pikës 10.1 të këtij neni, jashtë zonës urbane, pa ngarkesë, tarifa është 0.50 euro për kilometër, ndërsa me ngarkesë 1.00 euro për kilometër. Të njëjtat tarifa zbatohen edhe për automjetet nga paragrafi 2 i pikës 10.1 të këtij neni.

10.3. Kur procedura e zhvendosjes ka filluar, por automjeti nuk është zhvendosur deri në vendin e ruajtjes, zbatohet kjo tarifë:

1. në zonën urbane, tridhjetë (30) euro;
2. jashtë zonës urbane, tarifa llogaritet sipas paragrafit 10.2 të këtij neni, në përpjesëtim me distancën dhe angazhimin e realizuar.

10.5. Për zhbllokimin e automjeteve, autobusëve, automjeteve transportuese, automjeteve të punës, rimorkiove dhe gjysmë-rimorkiove, paguhet tarifë në shumën **tridhjetë (30) euro**.

10.7. Të gjitha pagesat sipas këtij neni bëhen përmes bankës, në mënyrën e përcaktuar me kontratë dhe me aktet përkatëse të Komunës së Prishtinës.